



Pranuar / Dorezuar Priljezhen / Priljezhen Received / Delivery	29.11.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	7487/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.914/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Çlirim Zeka Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.914/2022 të datës 14.10.2022, të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë në çështjen juridike “Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës ” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 29.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet Pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.914/2022 e datës 14.10.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Obligohet Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të inicioj veprimet e nevojshme ligjore për harmonizimin e koeficientit të nëpunësit civil nga koeficienti gjashtë (6) në koeficientin tetë (8).

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi sipas shkresave të lëndës është i punësuar në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, në pozitën “Inspektor Sanitar”, i njëjti ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 14.10.2022, me numër protokollit 6184/2022, me pretendimin për harmonizim të koeficientit në kuadër të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë

respektivisht të bëhet harmonizimi i koeficientit nga 6 ne koeficientin 8 ashtu siç e kanë pozitat e Inspektorëve në AUK, si dhe kërkon kompensimin retroaktiv nga data 20.10.2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.10.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, ndërsa Këshilli më datë 01.11.2022 me numër protokolli 6631/2022, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me numër protokolli 6184/2022 te datës 14.10.2022; Kërkesë për harmonizimin e pagave të shërbyesve civil (Inspektorëve) në kuadër të AUV-së me numër protokolli 6791 të datës 05.09.2022; Vendim me numër protokolli 7220-1 të datës 20.10.2021; Akt Emërim i S.K. me numër protokolli 7220-1 të datës 20.10.2021; E-mail nga Q.A. për V. Rr. etj. i datës 15.09.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokolli 6387/2022 e datës 21.10.2022; Përgjigje ne ankesë me numër protokolli 6631/2022 i datës 01.11.2022; E-mail nga Q.A. për F.K. i datës 01.04.2022; E-mail nga Q.A. për L.Z. i datës 09.03.2022; E-mail nga L.Z. për Q.A. i datës 07.03.2022; E-mail nga Q.A. për Sh.L. i datës 02.03.2022; E-mail nga Z.K. për Q.A. i datës 26.07.2022; E-mail nga Z.K. për G.T. i datës 22.06.2022; E-mail nga SH.L. për Z.K. i datës 20.06.2022; E-mail nga G.T. për SH.L. i datës 20.06.2022; E-mail nga F.T. për Sh.L. i datës 10.06.2022; E-mail nga F.K. për A.K. etj. i datës 10.06.2022; E-mail nga F.A. për Q.A. i datës 31.10.2022; E-mail nga F.A. për L.M. i datës 27.10.2022; E-mail nga F.K. për F.A. i datës 24.10.2022; E-mail nga F.K. për N.K. i datës 19.08.2022; Kërkesë për harmonizimin e koeficienteve për Inspektorët komunal të transferuar në AUV me numër protokolli 5527-2 i datës 26.07.2022; Formulari i shpenzimit të departamentit, divizionit ose sektorit, planifikimi për vitin 2022 1/6 faqe; Procedimi shtesë sipas pozitës Agjencia e Ushqimit dhe veterinarisë ZKM me numër protokolli 1444-1 i datës 28.03.2014; Pliko me numër 8330-1 i datës 31.10.2022; E-mail nga A.F. për B.S. i datës 19.08.2022 me numër protokolli 6225/2022 të datës 14.10.2022;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit, **është pjesërisht e bazuar, SEPSE:**

Bazuar në provat e lëndës është konstatuar se ankuesi është i punësuar sipas Akt Emërimit me nr. 7220-1 të datës 20.10.2021 në pozitën "Inspektor Sanitar" në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, me koeficient gjashtë (6) të pagës. I njëjti me datë 05.09.2022 ka parashtruar kërkesë me numër protokolli 6791 tek Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë për harmonizimin e koeficientit në kuadër të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë me pretendimet ankimore që ti bëhet harmonizimi i njëjtë i pagës me kolegët e tij nga koeficienti gjashtë (6) në koeficientin tetë (8) si dhe kërkon kompensimin retroaktiv nga dita e vendimit të transferimit me numër 7220-1 të datës 20.10.2021. Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë përmes e-mailit i është përgjigje në kërkesë me datë 15.09.2022 me të cilin e ka njoftuar se institucioni i tyre është duke bërë përpjekje maksimale për realizimin e kërkesës së ankuesit dhe

e ka njoftuar se janë në proces të zgjidhjes së kësaj çështje me arsyetimin se kjo varet ekskluzivisht nga Ministria e Punëve të Brendshme konkretisht Divizioni për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik.

Lidhur me pretendimin e ankuesit për harmonizim të koeficientit të pagës për pozitën e "Inspektorit Sanitar", Kolegji ju referua nenit 19 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik me të cilin është përcaktuar se: *"Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave"*, si dhe nenit 3 paragrafit 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë me të cilin parashihet se: *"Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë"*. Andaj mbi këtë bazë ligjore e nisur nga konstatimi si më lartë se ankuesi është emëruar në pozitën "Inspektor Sanitar" me koeficient gjashtë (6) të pagës, si dhe duke u bazuar në shkresën e datës 19.08.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik si organ përgjegjës për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave për pagat e zyrtarëve publik, me të cilin është konfirmuar se pozita inspektor-klasa profesionale 1, ka të përcaktuar koeficientin tetë (8) të pagës, Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimi ankimor i ankuesit për harmonizimin të koeficientit të pagës me titullin e punës është i drejtë dhe i ligjshëm.

Ndërlidhur me pretendimin ankimor si më lartë, Kolegji duke u bazuar në provat e lëndës ka gjetur se Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë konform kërkesës së ankuesit të datës 05.09.2022 lidhur me harmonizimin e koeficientit prej gjashtë (6) në tetë (8), të njëjtin Menaxheri i Personelit e ka njoftuar se institucioni i tyre është duke bërë përpjekje maksimale për realizimin e kërkesës së ankuesit dhe e ka njoftuar se janë në proces të zgjidhjes së kësaj çështje me arsyetimin se kjo varet ekskluzivisht nga Ministria e Punëve të Brendshme konkretisht Divizioni për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, përkundër pranimin të shkresës zyrtare me numër të protokollit 1444 të datës 28.03.2014 të Drejtorit të Ministrisë së Administratës Publike me të cilin është përcaktuar decidivisht se për pozitat e Inspektoreve janë të planifikuara mjete buxhetore atëherë pozita e punës inspektor duhet të nivelizohet, dhe paga bazë duhet të jetë me koeficient tetë (8). Kolegji i Këshillit po ashtu ka gjetur se Udhëheqësi i Divizionit të Pagave dhe Zhvillimit të Strukturave Funktionale pranë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik me datën 19.08.2022 përmes e-mailit i është drejtuar Komunës së Mitrovicës duke i sqaruar se pozita e Inspektoreve është pozitë Profesional 1 me koeficient 8 të pagës, kështu që mbi bazën e këtyre fakteve rrjedhë se mos harmonizimi-zbatimi i koeficienteve të ndryshëm të pagës për pozitë të njëjtë të punës sipas Rregullores Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, rrjedhimisht në gjykimin e Kolegjit veprimet e tilla bien ndesh edhe me dispozitat e nenit 2 dhe 4 të Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi si dhe nenin 7 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin parashihet se: *"Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mos diskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë..."*, kështu që Kolegji vlerëson se janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit mbi bazën e harmonizimit të koeficientit të pagës me Inspektorët e tjerë të sektorëve brenda Komunës.

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për kompensimin në mënyrë retroaktive të koeficientit të pagës për pozitën "Inspektor Sanitar" duke filluar nga data 01.08.2021 e tutje, Kolegji

bazuar në provat e kësaj çështje nuk ka gjetur asnjë dëshmi se ankuesi pas nënshkrimit të Aktit të Emërimit me numër protokolli 7220-1 të datës 20.10.2021 apo dhe para kërkesës së datë 05.09.2022 të këtë ndërmarr ndonjë veprim juridik lidhur me harmonizimin e koeficientit të pagës apo heshtjes administrative të organit të punësimit lidhur me kërkesën e tij për harmonizim të koeficienti, kështu që Kolegji konstaton së ky pretendim ankimor është i pa bazuar dhe i parashtruar në kundërshtim me nenin 127 paragrafi 1, 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar si në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.


Kolegji pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon e ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda. A.nr.914/2022

Çlirim ZEKA


Procesmbajtës



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencisë e Ushqimit dhe Veterinarisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencisë e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

